
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A

Data: 16. 01 .2026

Procesverbal – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

“MOBILIMI I SPITALIT TË KARDIOKIRURGJISË NË QSUT”

Loti 1: Mobilje dhe paisje për përdorim zyre dhe ambiente të tjera

Loti 2: Mobilje dhe paisje mjekësore profesionale për kardiokirurgjinë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mobilje dhe paisje të ndryshme CPV 39290000-1

Mobilje për përdorim mjekësor CPV 33192300-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 25 910 735.82 (njëzet e pesë milion e nëntëqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH , ose 268 449.39** (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë pikë tridhjetë e nëntë) euro pa TVSH:

Loti 1. Fondi limit në vlerën **13 204 675.47** (trembëdhjetë milion e dyqind e katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë dyzet e shtatë) lekë pa TVSH / ose

136 807.66 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e shtatë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) euro pa tvsh

Loti 2. Mobilje dhe paisje mjekësore profesionale për kardiokirurgjinë, me fond limit në vlerën **12 706 060.35** (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH /ose

131 641.73 (njëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet e një pikë shtatëdhjetë e tre) euro pa tvsh

Vlerat në euro në këto dokumente tenderi janë konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 16.01.2026, me kurs këmbimi 96.52 (nëntëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e dy)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Loti 1. Mobilje dhe paisje për përdorim zyre dhe ambiente të tjera

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit / shumatores së loteve për të cilat konkurrojnë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet

dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit / shumatores së loteve për të cilat konkurrojnë**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” / ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuara se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të

drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar me mall cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001:2015 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

3. Nëse është prodhues, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 7 (shtatë) punonjës, me kualifikimet si më poshtë:

1. 1 (një) inxhinier druri, vërtetuar me:

- Kontratën individuale të punës;
- Diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

2. 2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

3. 1 (një) Bojaxhi/llustrues për prodhime druri, vërtetuar me:

- Kontratën individuale të punës;
- Diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

4. 1 (një) shofer vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim.
- leje drejtimi, e vlefshme;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi ose kontrate shërbimi.

5. 2 (dy) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

***Shënim:** Kërkesa e mësipërme nr. 3 konsiderohet e përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar në të cilën përcaktohet : 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Kjo kërkesë është vendosur duke u referuar gjithashtu në nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë prodhues të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 7 punonjësish është përcaktuar duke u mbështetur në natyrën dhe vlerën e këtij loti, duke marrë në konsideratë edhe vendin ku do të kryhet furnizim-vendosja, në Spitalin e Ri të Kardiokirurgjisë pranë QSU “Nënë Tereza”, Tiranë, i cili bazuar në ligjin nr. 55/2022 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është i një rëndësie të veçantë dhe ofron shërbime të specializuara mjekësore, të kategorisë terciare.

Arsyetimi i rëndësisë së profesioneve të zgjedhura:

- 1 (një) inxhinier druri.

Sigurimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe plotësimi i standarteve të produkteve: Një inxhinier druri ka aftësitë dhe njohuritë për të analizuar, përzgjedhur dhe trajtuar materialet e drurit, për të siguruar që mobiljet janë të qëndrueshme dhe rezistente në kohë. Ai mund të sigurojë që lëndët e para të përmbushin specifikimet teknike dhe që produkti përfundimtar të jetë i cilësisë së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Mobiljet kanë të specifikuar disa standarte, dhe një inxhinier druri ka njohuritë e duhura për t'i zbatuar këto standarte gjatë procesit të prodhimit të tyre. Ai është i kualifikuar për të ndihmuar në përzgjedhjen e konstruksioneve të përshtatshme që sigurojnë stabilitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e produkteve. Një inxhinier druri mund të mbykqyrë aspekte të sigurisë për produktet përfundimtare, që ato nuk paraqesin rrezik për përdoruesit e tyre. Rëndësia e kërkesës për staf të kualifikuar, për një inxhinier druri, qëndron në garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike, për të reduktuar kostot dhe për të ofruar siguri dhe qëndrueshmëri në përdorimin e produkteve nga Autoritet Kontraktore përfituese në këtë procedurë prokurimi.

2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri:

Një marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri ka njohuritë e duhura në lidhje me përpuniminin edhe montimin e saktë të pjesëve të mobiljeve. Ai është i aftë të zbatojë me saktësi udhëzimet teknike dhe të sigurojë që çdo pjesë e montuar të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky specialist ndikon në shmangjen e gabimeve që ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke ulur riskun e defekteve dhe problemeve gjatë përdorimit. Cilësia, stabiliteti dhe siguria janë thelbësore për mobiljet që përdoren në ambjente publike, pasi montimi i gabuar i tyre

mund të rrezikojë punonjësit që do t'i përdorin ato. Gjithashtu siguron që montimi/ asemblimi apo procese të tjera të punës të kryhen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

1(një) Bojaxhi/Ilustrues për prodhime druri

Një bojaxhi/ilustrues i prodhimeve të drurit profesionist siguron që mobiljet të kenë një përfundim të lëmuar dhe të qëndrueshëm, gjë që përmirëson dukshëm pamjen estetike të mobiljeve dhe i bën ato të përshtatshme për përdoruesit përfundimtar, vecanërisht kur mobiljet janë pjesë e ambjenteve publike. Përdorimi jo vetëm i bojës cilësore, por edhe aplikimi i duhur nga një specialist, rrit rezistencën e mobiljeve ndaj lagështisë, pluhurit, konsumimit apo faktorëve të tjerë të jashtëm dhe kjo bën të rritet qëndrueshmëria apo jetëgjatësia e tyre, duke ulur nevojën për riparime apo zëvendësime të shpeshta. Aplikimi i bojës nga një profesionist i kualifikuar ndihmon në shmangjen e defekteve si njollat, mbeturinat apo përhapje e pabarabartë e bojës, Bojaxhiu profesionist është i trajnuar për të zgjedhur bojërat që janë në përputhje me standartet e sigurisë dhe mjedisit, gjë që ndihmon në sigurimin e një mjedisi të sigurt për përdoruesit e tyre që janë punonjësit e Autoriteteve Kontraktore përfituese. Kërkesa për një bojaxhi druri profesionist është një tregues i standarteve të larta të cilësisë në produktin përfundimtar.

Punonjësit e tjerë si shoferi dhe punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për transportin dhe punën ndihmëse që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës. Duke qënë se mjetet e transportit mund të jenë edhe me qera, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që shofertët mund të diponohen edhe me kontraktim.

Këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkohen nga Autoritetet Kontraktore, pra objekti i prokurimit ka si proces prodhimin ose porosinë, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e Autoriteteve Kontraktore përfituese.

Ky numër punonjësish është minimale që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

4. Nëse nuk është prodhues, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) punonjës, me kualifikimet si më poshtë:

1. 2 (dy) montues mobiljesh vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

2. 1 (një) shofer vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim (jo detyruesisht në listëpagesë).
- leje drejtimi, e vlefshme;

3. 2 (dy) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse gjatë procesve të punës vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

***Shënim:** Kërkesa e mësipërme nr. 4 konsiderohet e përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar në të cilën përcaktohet : 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Kjo kërkesë është vendosur duke u referuar gjithashtu në nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë, të cilët nuk janë prodhues të mallrave objekt prokurimi të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 5 punonjësish është përcaktuar duke u mbështetur në natyrën dhe vlerën e këtij loti, duke marrë në konsideratë edhe vendin ku do të kryhet furnizim-vendosja, në Spitalin e Ri të Kardiokirurgjisë pranë QSU “Nënë Tereza”, Tiranë, i cili bazuar në ligjin nr. 55/2022 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është i një rëndësie të veçantë dhe ofron shërbime të specializuara mjekësore, të kategorisë terciare.

Ky kompleksitet kërkon organizim të posaçëm të punës, koordinim të njëkohshëm të disa proceseve (transport, montim, instalim dhe dorëzim etj..), duke respektuar kërkesat teknike dhe funksionale. Për më tepër, natyra specifike e ambjentëve spitalore dhe paisjeve që do të instalohen inponon angazhimin e personelit të kualifikuar dhe të mjaftueshëm, për të garantuar cilësi, siguri dhe funksionim korrekt të mobilimit.

Për këto arsye kërkesa konsiderohet proporcionale, e arsyeshme dhe e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës.

Arsyetimi i rëndësisë së profesioneve të zgjedhura:

2 (dy) montues mobiljesh:

Një montues mobiljesh ka njohuritë e duhura në lidhje me montimin e saktë të pjesëve të mobiljeve. Ai është i aftë të zbatojë me saktësi udhëzimet teknike dhe të sigurojë që çdo pjesë e montuar të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky specialist ndikon në shmangjen e gabimeve që ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke ulur riskun e defekteve dhe problemeve

gjatë përdorimit. Cilësia, stabiliteti dhe siguria janë thelbësore për mobiljet që përdoren në ambiente publike, pasi montimi i gabuar i tyre mund të rrezikojë punonjësit që do t'i përdorin ato. Gjithashtu siguron që montimi/ asemblimi apo procese të tjera të punës të kryhen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Punonjësit e tjerë si shoferi dhe punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për transportin dhe punën ndihmëse që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës. Duke qenë se mjetet e transportit mund të jenë edhe me qera, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që shofertët mund të diponohen edhe me kontraktim.

5.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **katalogët / fragmente të katalogut ose skedat teknike** për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / fragmenteve të katalogut ose skedave teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi është e nevojshme dhe e justifikuar, pasi shërben për verifikimin objektiv të përputhshmërisë së mallrave të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin mobilim dhe pajisje që do të përdoren në ambiente spitalore dhe njësi të specializuara shëndetësore, autoriteti kontraktor duhet të sigurohet që produktet e ofruara plotësojnë kërkesat teknike, funksionale dhe cilësore, si dhe standardet përkatëse të sigurisë dhe përdorimit. Në këtë kuadër, katalogët dhe skedat teknike përbëjnë dokumentacion thelbësor për të vlerësuar karakteristika të tilla si materialet e përdorura, përmasat, konfigurimi teknik, standardet e prodhimit dhe mënyra e funksionimit.

Paraqitja e këtij dokumentacioni nga operatorët ekonomikë mundëson një vlerësim të drejtë dhe transparent të ofertave, garanton trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe i jep autoritetit kontraktor mundësinë të konstatojë nëse mallrat e ofruara janë në përputhje të plotë me kërkesat teknike të parashikuara.

Për këto arsye, kërkesa për paraqitjen e katalogëve dhe skedave teknike konsiderohet e arsyeshme, proporcionale dhe e lidhur ngushtë me objektin dhe natyrën e kontratës.

6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet transporti	1 copë	Pronësi / qera/ huapërdorje

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruara me qera/huapërdorje, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse.

Shenim: Kërkesa e mësipërme nr. 6 konsiderohet e përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit që kërkohet, afatin e lëvrimit të tij nga data e nënshkrimit të kontratës brenda afatit e marreveshjes kuadër.

7. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 vjecare të garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit, pa faj të autoritetit kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për cilësinë e artikujve objekt prokurimi, si dhe për garancinë, se çdo dëmtim apo problematikë që vjen pa faj të AK, të riparohet me shpenzimet e operatorit ekonomik. Kjo kërkesë është proporcionale dhe e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe synon ofertimin nga OE / BOE të përgjegjshëm që janë të gatshëm të realizojnë objektin e prokurimit në cilësi dhe në kohë, si dhe të mbajnë përgjegjësi për të gjitha problematikat që mund të pasojnë, deri në 1 (një) vit pas realizimit të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Loti 2. Mobilje dhe pajisje mjekësore profesionale për kardiokirurgjinë

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit / shumatores së loteve për të cilat konkurrojnë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të

ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes

dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit / shumatores së loteve për të cilat konkurrojnë**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
- c) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. “Autoriteti/enti kontraktor,

për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

ISO 13485:2016 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për sistemet e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore. Ky standard është i nevojshëm përsa i përket sigurisë dhe efektivitetit të produkteve, duke përmblusur kërkesat rregullatore dhe duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë. Një ndër aspektet kryesore të ISO 13485:2016 përfshin dhe Menaxhimin e riskut: Fokus në identifikimin dhe menaxhimin e risqeve që lidhen me sigurinë dhe performancën e pajisjeve mjekësore. Përputhshmëria rregullatore: Sigurimi që pajisjet mjekësore përputhen me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Kontrolli i furnitorëve: Kërkesa për vlerësimin dhe monitorimin e furnitorëve për të siguruar cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të tyre.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë "Licencë / autorizim për tregtim me shumicë të pajisjeve mjekësore", të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 "Për pajisjet mjekësore", i ndryshuar, i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës." dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: "4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

Bazuar në nenin 40 pika 5/a përcaktohet se: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;"

Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore," i ndryshuar, ku në nenin 4 pika 1 e në vijim të tij përcaktohet se: *"Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. "Pajisje mjekësore" është çdo instrument, aparat, material ose mjet tjetër, i përdorshëm vetëm ose i kombinuar dhe që veprimin e synuar në ose mbi trupin e njeriut e kryen i ndihmuar nga mjete farmakologjike, imunologjike apo metabolike: a) për diagnostikimin, parandalimin, monitorimin, trajtimin ose zbutjen e sëmundjes; b) për diagnostikimin, monitorimin, trajtimin, zbutjen ose kompensimin e një dëmtimi apo të mete; c) për hetimin, zëvendësimin ose modifikimin e anatomisë apo të një procesi fiziologjik; ç) për kontrollin e ngjizjes; d) produkte të dedikuara posaçërisht për pastrimin, dezinfektimin ose sterilizimin e pajisjeve; dh) pajisjet të cilat nuk janë të destinuara për një qëllim të caktuar mjekësor si më poshtë: i) produkte të destinuara për t'u futur plotësisht ose pjesërisht në trupin e njeriut përmes mjeteve invazive kirurgjikale, me qëllim të modifikimit të anatomisë ose fiksimit të pjesëve të trupit, me përjashtim të produkteve për tatuazhe dhe piercing; ii) substancat, kombinime të substancave, ose produkte të destinuara për t'u përdorur për mbushjen e mukozës së fytyrës ose zona të tjera të lëkurës ose mukozës me anë të injeksionit subkutan, submukozë ose intradermal, duke përjashtuar ato për tatuazhe; iii) pajisjet e destinuara për t'u përdorur për të zvogëluar, hequr ose shkatërruar indin dhjamor, siç janë pajisjet për liposuction, lipolizë ose lipoplastikë; iv) rrezatimi elektromagnetik me intensitet të lartë, të tilla si: pajisje që lëshojnë rrezatim infra të 2 kuq, dritë të dukshme dhe ultra vjollcë, të destinuar për përdorim në trupin e njeriut, duke përfshirë burime koherente dhe jokohherente, spektër monokromatik dhe të gjerë, si lazer dhe pajisje të lehta me puls intens, për rishfaqjen e lëkurës, tatuazhi ose heqja e flokëve ose trajtim tjetër i lëkurës; v) pajisjet e destinuara për stimulimin e trurit që aplikojnë rryma elektrike ose fusha magnetike ose elektromagnetike që depërtojnë në kranium për të modifikuar aktivitetin neuronal në tru. 2. "Aksesor" është mjeti, i cili, megjithëse nuk klasifikohet si pajisje mjekësore, është destinuar specifikisht nga prodhuesi i tij për t'u përdorur së bashku me një pajisje mjekësore, duke mundësuar që pajisja mjekësore të përdoret në përputhje me përdorimin e saj të synuar. 3. "Pajisje mjekësore e diagnostikimit in vitro" është një reagent, produkt reagenti, produkt kalibrator, material kontrolli, kit, instrument, aparat, pajisje apo sistem, që përdoret vetëm ose në kombinim, i destinuar nga prodhuesi për t'u përdorur in vitro për ekzaminimin e mostrave, përfshirë gjakun dhe indet, që rrjedhin nga trupi i njeriut, me qëllim sigurimin e informacionit: a) lidhur me një gjendje fiziologjike ose patologjike; b) lidhur me një anomali kongjenitale; c) për të përcaktuar sigurinë dhe përshtatshmërinë me një pranues potencial; ç) për të monitoruar masat terapeutike. 4. "Pajisje për vetëtestim" është çdo pajisje e synuar nga ana e prodhuesit për t'u përdorur nga joprofesionistë në mjedisin e shtëpisë. 5. "Pajisje për vlerësimin e performancës" është çdo pajisje e synuar nga ana e prodhuesit për të kryer një ose më shumë studime vlerësuese të performancës në laboratorë për analiza mjekësore ose në mjedise të tjera të përshtatshme. 6. "Pajisje mjekësore aktive" është çdo pajisje mjekësore, veprimtaria e së cilës varet nga një burim i energjisë elektrike ose çdo burim tjetër alternativ. 7. "Pajisje mjekësore e implantueshme aktive" është çdo pajisje mjekësore aktive, e cila ka për qëllim të jetë krejtësisht apo pjesërisht e futur, nëpërmjet procedurave kirurgjikale apo mjekësore, në trupin e njeriut në kavitetet natyrale dhe është e menduar të mbetet aty pas kësaj procedure. 8. "Pajisje me porosi" është çdo pajisje e prodhuar sipas përshkrimit me shkrim të një mjeku të kualifikuar, që jep nën përgjegjësinë e tij karakteristika specifike të prodhimit dhe ka për qëllim të përdoret te një pacient i veçantë. Pajisjet e prodhuara në masë, të cilat duhet të përshtaten në mënyrë që të plotësojnë kërkesat specifike të mjekut apo të ndonjë përdoruesi tjetër profesional nuk konsiderohen pajisje me porosi. 9. "Pajisje e destinuar për hetimin klinik" është çdo pajisje e destinuar për t'u përdorur nga një person i kualifikuar për të kryer hetime klinike në një mjedis të përshtatshëm njerëzor." dhe nenit 22 të ligjit ku përcaktohet se: "1. Tregtimi me shumicë i pajisjeve mjekësore kryhet nga tregtuesit me shumicë, të cilët janë persona juridikë të licencuar për këtë veprimtari, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet. Kushtet e licencimit, dokumentet shoqëruese, afatet e vlefshmërisë dhe procedurat e shqyrtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministri përgjegjës për shëndetësinë është organi që shqyrton dhe merr vendimin përfundimtar për kërkesat për*

pajisjen me licencë për tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore. Ministri përgjegjës për shëndetësinë është autoriteti përgjegjës për revokimin dhe pezullimin e kësaj licence. 2. Tregtuesi me shumicë i pajisjeve mjekësore kryen importin dhe eksportin e pajisjeve mjekësore. 3. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave listën e tregtarëve me shumicë dhe, rast pas rasti, e njofton këtë drejtori për ndryshime apo shtesa të mundshme në këtë listë”. Referuar këtyre dispozitave, si dhe bazuar në të dhënat teknike të përcjella nga autoriteti kontraktor përfitues Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, mallrat objekt prokurimi të kërkuara konsiderohen si pajisje mjekësore, për të cilat ligji parashikon që treguesit e këtyre mallrave duhet të pajisjen me autorizim/licence nga strukturat përgjegjëse.

Kërkesa përsa i përket këtij autorizimi/licencimi synon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje të sigurisë dhe shëndetit për pacientët, përdoruesit dhe palët e treta. Për autorizimin/licencimin e tregtimit të pajisjeve mjekësore, kriteret e kualifikimit përfshijnë përputhjen me standardet e sigurisë dhe efektshmërisë të përcaktuara nga prodhuesi, si dhe respektimin e procedurave të regjistrimit dhe vlerësimit të konformitetit të pajisjeve mjekësore sipas parashikimeve ligjore. Ky kriter është një garanci për autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës e ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit në fuqi për pajisjet mjekësore.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij.**

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në neni 40/3/ 8 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 8 përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj,

autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale dhe të cilësisë nga operatori ekonomik pjesëmarrës. Autorizimi i prodhuesit/ ose distributorit të autorizuar duhet të paraqitet nga operatori ekonomik, pasi vërteton që prodhuesi/ distributor i autorizuar, autorizojnë operatorin ekonomik të tregtojë produktin e tij në Republikën e Shqipërisë. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të drejtat ligjore nga prodhuesi për të ofertuar mallin e kërkuar, origjinale të prodhuara nga prodhuesi. Në rast se ofertuesi e ka marrë të drejtën për të ofertuar mallin e kërkuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi atëherë, ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Synimi i kësaj kërkesë për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallrat, me garanci e suport teknik.

5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët / fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / fragmenteve të katalogut ose skedave teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi është e nevojshme dhe e justifikuar, pasi shërben për verifikimin objektiv të përputhshmërisë së mallrave të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin mobilim dhe pajisje që do të përdoren në ambiente spitalore dhe njësi të specializuara shëndetësore, autoriteti kontraktor duhet të sigurohet që produktet e ofruara plotësojnë kërkesat teknike, funksionale dhe cilësore, si dhe standardet përkatëse të sigurisë dhe përdorimit. Në këtë kuadër, katalogët dhe skedat teknike përbëjnë dokumentacion thelbësor për të vlerësuar karakteristikat të tilla si materialet e përdorura, përmasat, konfigurimi teknik, standardet e prodhimit dhe mënyra e funksionimit.

Paraqitja e këtij dokumentacioni nga operatorët ekonomikë mundëson një vlerësim të drejtë dhe transparent të ofertave, garanton trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe i jep autoritetit kontraktor mundësinë të konstatojë nëse mallrat e ofruara janë në përputhje të plotë me kërkesat teknike të parashikuara.

Për këto arsye, kërkesa për paraqitjen e katalogëve dhe skedave teknike konsiderohet e arsyeshme, proporcionale dhe e lidhur ngushtë me objektin dhe natyrën e kontratës.

6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet transporti	1 copë	Pronësi / qera/ huapërdorje

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruar me qera/huapërdorje, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse.

Shenim: Kërkesa e mësipërme nr. 6 konsiderohet e përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit që kërkohet, afatin e lëvrimit të tij nga data e nënshkrimit të kontratës brenda afatit të marreveshjes kuadër.

7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjës, me kualifikimet si më poshtë:

- 1 (një) shofer vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim (jo detyrimisht në listëpagesë).
- leje drejtimi, e vlefshme;

- 2 (dy) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse gjatë procesve të punës vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

***Shënim:** Kërkesa e mësipërme nr. 4 konsiderohet e përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se

operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar në të cilën përcaktohet : 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Kjo kërkesë është vendosur duke u referuar gjithashtu në nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 3 punonjësish është përcaktuar duke u mbështetur në natyrën, numrin e artikujve, sasi të respektive dhe rrjedhimisht vlerën e këtij loti. Për të realizuar objektin e prokurimit dhe vendosur artikujt në destinacionet përkatëse, është gjykuar e arsyeshme përcaktimi i punonjësve të thjeshtë.

Në përfundim, kjo kërkesë vlerësohet proporcionale dhe e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

8. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 vjecare të garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit, pa faj të autoritetit kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për cilësinë e artikujve objekt prokurimi, si dhe për garancinë, se çdo dëmtim apo problematikë që vjen pa faj të AK, të riparohet me shpenzimet e operatorit ekonomik. Kjo kërkesë është proporcionale dhe e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe synon ofertimin nga OE / BOE të përgjegjshëm që janë të gatshëm të realizojnë objektin e prokurimit në cilësi dhe në kohë, si dhe të mbajnë përgjegjësi për të gjitha problematikat që mund të pasojnë, deri në 1 (një) vit pas realizimit të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

LOTI 1. Mobilje dhe paisje për përdorim zyre dhe ambiente të tjera

Nr.	Emërtimi i artikujve
-----	----------------------

1	Dollap dhome pacienti (dy kanata) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (90 x45/ h = 190) cm, Max (100x 50/ h= 200)cm
2	Dollap dhome pacienti (nje kanate) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (45 x45/ h = 190) cm, Max (50x 50/ h= 200)cm
3	Dollap/ Zyrë mjeku Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (80 x45/ h =200) cm, Max (90x 55/ h= 210) cm
4	Dollap zyre Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (80 x45/ h =200) cm, Max (90x 55/ h= 210) cm
5	Tavolinë drejtkëndore/ zyre Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (160 x 80/ h= 65), Max (170x 90/ h= 75) cm
6	Tavolinë zyre/ (Model II) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (140 x 70/ h= 65), Max (150x 80/ h= 75) cm
7	Tavolinë zyre/ (Model III) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (120 x 60/ h= 65), Max (130x 70/ h= 75) cm
8	Komodinë Zyre Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (40x 60/ h=65), Max (50x 65/ h= 70) cm
9	Tavolinë zyre mesi Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (50x 50/ h=40), Max (60x 60/ h= 50) cm
10	Tavolinë sallë mbledhjesh Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (220x90x65), Max (230x100/ h= 75) cm
11	Tavolinë sallë mbledhjesh/ salle konferencash Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (300 x90x65), Max (310 x100/ h= 75) cm
12	Etazher për dosje me kanata dhe xham Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min(90 x 45 x/ h= 200), Max (100x 55x / h= 210) cm
13	Kolltuk me hapje (behet shtrat tek) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (75 x 75/ h= 80), Max (85 x 85 x/ h= 90) cm

14	Poltron pritje dyvendesh (kolltuk dyvendesh) <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (186x 95x 94)cm dhe Max(200x100x/ h=100)cm</i>
15	Poltron pritje njëvendësh (kolltuk njëvendesh) <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min(92x 89x 84) cm dhe Max(100x 95x100)cm</i>
16	Karrige ergonomike (me mbështetese koke) <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Dimensionet e ndenjësës: gjerësia jo më pak se 480 mm, thellësia jo më pak se 480 mm. (mbështetësja 570x475)mm</i>
17	Poltron rrotulluese (Drejtuesi)
18	Poltron statik për tavolinë mbledhje
19	Karrige plastike/ Zyre <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min(45x 45/ h= 45), Max(55x55/ h= 50) cm</i>
20	Karrige plastike <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min(45x 45/ h= 45), Max(55x55/ h= 50) cm</i>
21	Recepsioni <i>Përmasat sipas specifikimeve teknike</i>
22	Tavoline/ Dhome relaxi <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (150x80/ h= 65), Max (160x90/ h= 75) cm</i>
23	Mobilje kuzhine/ Bufe <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Pjesa e sipërme: Min (180x50/ h=80), Max (200x60/ h=90) cm. Pjesa e poshtme: Min (180x 30/ h=30), Max (200x35/ h=45) cm</i>
24	Mobilje kuzhine/ Bufe <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Pjesa e sipërme: Min (180x50/ h=80), Max (200x60/ h=90) cm.</i>
25	Stol për ambient veshje- zhveshje <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (100x40/ h= 45)cm dhe Max (110x50/ h= 55) cm</i>
26	Tavolinë/ Sallë leksioni <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (170x50/ h= 65), Min (180x60/ h=75) cm</i>

27	Karrige për Salla konferencash Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min Ndenjesja(47x44/ h=45), Max(55x55/ h=50) cm
28	Karrige rrotulluese me ndryshim lartësie Përmasat (lartësi): (44-54)cm
29	Frigorifer / Kuzhine Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (60x 60x 170), Max (70x70/ h=180) cm
30	Mikrovale Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): (40x20x30) cm, Max (50x30x 40)cm
31	Varese rrobash e fiksuar ne mur Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (70 x 90), Max (80 x 100) cm
32	Tavoline referimi salle Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (80 x 60 x 125) cm
33	Karroce pastrimi Kapaciteti 120 litra

Specifikimi i Materialeve:

Bashkëngjitur me DST është katalogu me foto ilustruese dhe specifikime më të detajuara

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Furnizimi dhe vendosja do të kryhet në Godinën e Spitalit të Kardiokirurgjisë, Kirurgjisë Vaskulare në QSU “Nënë Tereza”, sipas të gjitha Specifikimeve teknike bashkëlidhur.

Përpara se të prodhohen ose blihen, artikujt (mallrat) objekt prokurimi, duhet të bëhen matjet në objekt në mënyrë që të kenë hapësirën dhe vendin e duhur ku do të vendosen.

Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues **Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë**, në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Neni 36 pika 3 përcakton: 3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

Duke ju referuar nenit 36 autoriteti kontraktor përfitues **Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë**, ka hartuar specifikimet teknike të cilat shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Transporti/montimi dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

Loti 2. Mobilje dhe pajisje mjekësore profesionale për kardiokirurgjinë

Nr.	Emërtimi i artikujve
1	Komodine dhome pacienti Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (45x 50/ h= 75)cm Max (55x 60/ h= 80) cm. Dimensionet e tavolines se integruar Min(70x40/h=98)cm dhe Max(85x45/ h=116)cm
2	Dollap inoxi për Reanimacion Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (250 x 50/ h= 210), Max (260x 55/ h=220) cm
3	Rafte inoxi Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (70 x 45/ h= 190), Max (80 x 50 h= 200) cm
4	Dollap rrobash metalik për personelin 2(dy) kanata Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):Min (65x40/ h=180), Max(70x50/ h=190) cm
5	Dollap rrobash metalik për personelin 6 (gjashtë) kanata Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi):Min (99x50/ h=180), Max(110x50/ h=190) cm
6	Stol metalik për pritje/ holl (Tre vende) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (150 x 40/ h=45), Max(160x 50/ h=50) cm
7	Stol metalik për pritje/ holl (Dy vende) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (110 x 40/ h=45), Max(120x50/ h=50) cm
8	Karrige bariatrike Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Ndenjësja Min (71x50/ h= 40), Min (76x60/ h=50) cm
9	Mbajtese kepucesh Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min Ndenjesja(900x600/ h=1620)mm, Max(1000x700/ h=1700) mm
10	Dollap metalik inoksi me kanata me xham (Dy kanata) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (70x45/ h=190), Max(90 x55/ h=200) cm
11	Dollap metalik për salla Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min(60x60/ h=190), Max (70x 65/ h= 200) cm
12	Dollap metalik/ Dokumenta Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (90 x40/ h=190), Max(100x50/ h=200) cm
13	Dollap metalik inoxi Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (110 x50/ h=200), Max(120x60/ h=210) cm
14	Perde ndarëse ambienti Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (190x170/ h= +/-180)cm , Max(200x180/ h= +/-190) cm
15	Karroçë mjekësore Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi) Min(600x480/ h=950)mm, Max(650x 530x/ h=1000)mm
16	Karroçë manipulimi per sherbimet Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min(630x470/ h=920)mm, Max(680x520x/ h=970/)mm
17	Karroçë emergjence Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi) Min(750 x 480 x 940)mm, Max(800 x 530 x 990) mm

18	Dollap inoxi per bllokun operator Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi) Min(1200x 620 x 850)mm, Max(1250x 670 x 900) mm
19	Stol rrotullues kirurgjikal Përmasat (gjerësi x lartësi):(Ø540 / h=600)mm. Ndenjesja(min Ø360 dhe Max Ø 420)mm
20	Stol ndihmës Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (40x30/ h= 20), Max (50x 40/ h= 30) cm
21	Stol ndihmës për sallë operacioni Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (600x 350/ h=250)m, Max(650x400x300)mm
22	Stativ
23	Tavoline per materiale Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (620x420x820)m, Max(870x550x910)mm
24	Tavolinë anestezie Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (65x48/ 90) cm, Max (75x60/ 110)cm
25	Tavoline inoxi ne Reanimacion Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (290x80x65) cm, Max (300x90x75)cm
26	Karroce inoxi per bllokun operator Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (95x55x70) cm, Max (105x65x80)cm
27	Tavolinë për instrumenta Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (120x 50x 84), Max (130x60/ h=90) cm
28	Karroce mjekimi Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (750x500x1000)mm, Max (800x550x1050)mm
29	Karroce instrumentash Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min (60x50/ h= 80), Max (65x55/h=120) cm
30	Frigorifer per ruajtjen e ilaceve (insulina, albumina,etj) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): (470×450×670) mm
31	Karroce shumepërdorimshe sherbimi Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min(1050 x 600 x 830)mm, Max (1080 x 630 x 860)mm

Specifikimi i Materialeve:

Bashkëngjitur me DST është katalogu me foto ilustruese dhe specifikime më të detajuara

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Furnizimi dhe vendosja do të kryhet në Godinën e Spitalit të Kardiokirurgjisë, Kirurgjisë Vaskulare në QSU “Nënë Tereza”, sipas të gjitha Specifikimeve teknike bashkëlidhur.

Përpara se të prodhohen ose blihen, artikujt (mallrat) objekt prokurimi, duhet të bëhen matjet në objekt në mënyrë që të kenë hapësirën dhe vendin e duhur ku do të vendosen.

Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues **Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë**, në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Neni 36 pika 3 percakton: 3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë*

të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

Duke ju referuar nenit 36 autoriteti kontraktor përfitues **Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë**, ka hartuar specifikimet teknike të cilat shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Transporti/montimi dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT